



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.5342 /2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 neni 3, paragrafi 1.40, 1.41, neni 16 paragrafi 1, Ligjin Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 27, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.08.2020 merr:

V E N D I M

PËR RIALOKIM DHE TRANSFER TË MJETEVE NË KATEGORITË EKONOMIKE SHPENZIME KAPITALE, MALLRA DHE SHËRBIME DHE REZERVA

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategoritë ekonomike shpenzime kapitale, mallra dhe shërbime dhe rezerva.
2. Rialokimi dhe transferi i mjeteve në total është në shumë prej 262,812.30 € nga fondet 10, 21 në kategoritë ekonomike shpenzime kapitale, mallra dhe shërbime dhe rezerva sipas tabelave 4.1 dhe 4.2 të bashkangjitur këtij vendimi.
3. Në bazë të pikës 2 Rialokimi i mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale është në shumë prej 116,076.30 €. Transferi mjeteve nga kategoria rezerva në ate mallra dhe shërbime është në shumë prej 14,785.00 €, ndërsa në kategorinë shpenzime kapitale është në shumë prej 131,951.00 €.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Financave - Departamenti i Buxhetit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 31.08.2020





01/Nr.5449 /2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimin Administrativ të MAPL-së nr.02/2019 për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane nenit 1 dhe 5, Rregulloren për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit 01/Nr.9274/2019 neni 4, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.08.2020 merr:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE LOKALE

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Hanit të Elezit.
2. Komisioni përbëhet prej 7 (shtatë) nga të cilët , 4 (katër) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjekte të ndryshme politike, 1 (një) anëtar nga ekzekutivi, 1 (një) nga shoqëria civile dhe 1 (një) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal.
3. Komisioni do të ketë këtë përbërje:-
 1. Samire Curri -LDK
 2. Isni Bushi - AAK
 3. Akif Shkreta-VV
 4. Besarta Suma -PDK
 5. Edon Curri- nga Ekzekutivi i Komunës
 6. Nusret Shiti - nga shoqëria civile
 7. Përfaqësuesi i fshatit përkatës.
4. Komisioni i themeluar nga Kuvendi i Komunës, nëpërmjet zyrës për informim, informon qytetarët 7 ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokale.
 - 4.1. Përmes shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet ku do të zgjedhen këshillat lokale:-
 - 4.1.1. Mediave lokale;
 - 4.1.2. Vebfaqes zyrtare të komunës.
 - 4.1.3. Rrjeteve sociale.
 - 4.2. Njoftimi i publikut duhet të përmbajë:-
 - 4.2.1. Rendin e ditës;
 - 4.2.2. Datën;
 - 4.2.3. Kohën;
 - 4.2.4. Vendin e mbajtjes së tubimit

5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komisionit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 31.08.2020

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava

